



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: **047**

SFIDA E DIZAJNIT NË MËSIMDHËNIEN DHE TË NXËNIT E TEKNOLOGJISË (KLASAT 6-9)

Tipi i programit: Themelor

Hyrje:

Programi i Arsimit Themelor (PATH) është një program pesëvjeçar i cili financohet nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) dhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), dhe implementohet nga FHI D360, me qëllim të ofrimit të përkrahjes për shkollat kosovare që të zhvillojnë shkathtësitë relevante të shekullit 21 të nxënësit. Programi i Arsimit Themelor përbëhet prej tri komponentëve kryesorë:

- (i) zhvillimi i kapacitetit të komunave dhe shkollave për udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollave
- (ii) zhvillimin e kapaciteteve të shkollave për vlerësimin për të nxënë dhe
- (iii) përmirësimin e zhvillimit të mësimdhënësve pa shpëputje nga puna.

Komponenti i tretë për zhvillimin e mësimdhënësve implementohet në partneritet me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), e cila i koordinon aktivitetet në këtë komponentë me një qasje të integruar dhe në bashkëpunim të ngushtë me personelin teknik të Programit për Arsimin Themelor.

Programi për Arsimin Themelor gjatë vitit 2011 ka zhvilluar një *program* koherent për zhvillimin profesional të mësimdhënësve pa shpëputje nga puna. Ky program dallon nga trajnimet e deritanishme për disa arsye. Së pari, për arsye sepse pjesa më e madhe e këtij programi zhvillohet me bazë në shkollë dhe ndërmerr një sërë masash për sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë:

1. Janë hartuar dhe miratuar Standardet e PATH për Fasilitimin e të Nxënësit;
2. Është hartuar dhe miratuar Lista e Shkathtësive Prioritare e PATH;
3. Janë hartuar, testuar dhe përgatitur për akreditim katër kurse për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
4. Janë zhvilluar kapacitetet për implementimin e këtyre katër kurseve (20 kryefasilitatorë dhe 73 fasilitatorë shkollorë);
5. Janë themeluar dhe pajisur Qendrat për Ngritje Profesionale (QNP);

6. Janë hartuar pakot teknologjike për kurset përkatëse dhe janë shpërndarë 17 pako në QNP, për të mundësuar implementimin e këtyre kurseve në nivel të QNP-së, dhe 41 pako në shkolla për të mundësuar implementimin e këtyre kurseve në nivel shkollash;
7. Janë hartuar Doracakët për kurset përkatëse për të ndihmuar shpërndarjen dhe informimin për qasjet e reja në mësimdhënie dhe të nxënë në shkollat kosovare.

Kurset për zhvillimin profesional të mësimdhënësve janë hartuar nga KEC-i në kuadër të jetësimit të këtij programit të PATH për ngritjen profesionale të mësimdhënësve kosovarë dhe janë në përputhje të plotë edhe me prioritetet dhe objektivat strategjike të Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit të MASHT (2011-2016) për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënimit në Kosovë. Qendra për Arsim e Kosovës është e përkushtuar ndaj ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënimit përmes zhvillimit profesional të mësimdhënësve pa shkopje nga puna. Deri tani KEC ka zhvilluar dhe implementuar me dhjetëra programe për aftësimin e mësimdhënësve vet dhe në bashkëpunim me partnerë vendorë e ndërkombëtar, përfshirë MASHT-in dhe drejtorit komunale të arsimit.

Kursi “Sfida e dizajnit në mësimdhënien dhe të nxënimit e teknologjisë”

Kursi i Sfidës së Dizajnit në Teknologji është zhvilluar në kuadër të përpjekjeve të Programit të Arsimit Themelor për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit 21 tek nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Kursi është hartuar nga një ekip i përbërë nga ekspertë e mësimdhënës vendorë e ndërkombëtarë të udhëhequr nga ekspertja shumë e njohur në fushën e teknologjisë arsimore, Dr. Sandie Kendall nga Britania e Madhe. Së bashku me të, në hartimin e kursit kanë marrë pjesë Rrezarta Pllana, si konsulente vendore, Valbona Kadriu, si autore e doracakut për fasilitatorët, dhe grupi punues i përbërë nga mësimdhënësit e teknologjisë nga shkollat udhëheqëse të Programit të Arsimit Themelor (lista e bashkëngjitur në fund të kësaj kërkesë). Kursi i Teknologjisë është hartuar në një proces të përbërë nga këto faza:

- Skica e parë e kursit (dorëzuar nga eksperti ndërkombëtar)
- Përpunimi i skicës në bashkëpunim me ekspertët vendorë
- Testimi i skicës në punëtorinë e parë provuese
- Hartimi i versionit të parë punues të kursit
- Testimi i versionit të parë në punëtorinë e dytë testuese
- Finalizimi i kursit (përfshirë auditimin gjinor)
- Finalizimi i materialeve të kursit (përfshirë përkthimin dhe redaktimin gjuhësor)
- Përgatitja për akreditim (përfshirë listën e fasilitatorëve) dhe
- Dorëzimi i kërkesës për akreditim në MASHT.

Qëllimet e kursit:

- Zbatimi i qasjes së sfidës së dizajnit në mësimdhënien dhe të nxënimit e teknologjisë në shkollat kosovare.
- Zbatimi i të nxënimit praktikë në lëndën e teknologjisë.
- Njohja me teknologjinë arsimore dhe me pajisjet e shekullit 21 për mësimdhënie dhe të nxënë të teknologjisë.

Rezultatet e të nxënit

Pas përfundimit të kursit, vijuesit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë konceptin e sfidës së dizajnit dhe e përdorin atë në jetësimin e lëndës së teknologjisë;
- Përdorin lego robotin, krahu robotik, flip kamerën dhe instrumente e pajisje të tjera në zhvillimin e lëndës së teknologjisë në shkollë;
- Përdorin qasjet dhe pajisjet e reja për implementimin e planit e programit të teknologjisë;
- Zhvillimi i shkathtësive praktike të nxënësve nëpërmjet të nxënit të teknologjisë.

Korniza e përgjithshme e kursit

Paraqitja e kornizës së përgjithshme të punëtorisë së aplikimit të sfidës së dizajnit në të nxënit e teknologjisë:

Sfida e dizajnit dhe veglat e punës	Ndërlidhja e sfidës së dizajnit me kurrikulën dhe tekstet e teknologjisë	Pajisjet e shekullit 21
Sfida e dizajnit	Sfida e dizajnit dhe arritja e kompetencave dhe rezultateve mësimore	Pajisje të ndryshme: Kutia kontrolluese
Te menduarit e dizajnit	Hulumtimi i teksteve shkollore për identifikimin e mundësive për aplikim të sfidës së dizajnit	Lego roboti, krahu robotik, flip-kamera
Veglat e punës dhe përdorimi i tyre – pakoja teknologjike	Ndërlidhja e pajisjeve të reja me kompetencat dhe rezultatet e të nxënit	Lidhja dhe programimi i pajisjeve me kompjuterë
Ndarja e detyrave për sfidën e dizajnit: Kolovajza	Të nxënit për të mësuar	Përdorimi i pajisjeve për sfidën e dizajnit

Implementimi i kursit (metoda, forma dhe vendi):

Kursi i Sfidës së dizajnit në lëndën e teknologjisë do të implementohet në dy mënyra:

- Si kurs treditor, në formë seminarike, në Qendrat për Ngritje Profesionale (20 orë)

Në këtë rast, kursi do të zbatohet nga dy-tre fasilitatorë shkollorë të aftësuar dhe të certifikuar nga PATH – KEC. Në kryerjen e kësaj faze fasilitatorët shkollorë do të jenë të përkrahur nga kyrefasilitatorët përkatës të certifikuar nga Programi i Arsimit Themelor. KEC – Programi i Arsimit Themelor do të sigurojë edhe materialet e duhura, doracakët, dhe teknologjinë arsimore për jetësimin e kursit. Gradualisht, shkollat dhe komunat do të inkurajohen për të marrë pjesë në sigurimin e kushteve për implementimin e kursit.

Për këtë punëtori tre-ditore (prej orës 9.30 deri 16.30), me dy sesione prej një orë e gjysmë paradite dhe me po aq sesione pasdite, vijuesit do të fitojnë 20 orë për llogari të procesit të licensimit të tyre.

ii. Në formë të nëntë aktiviteteve me bazë në shkollë (14 orë)

Përmbajtja e kursit do të zbatohet nga mësimmhënësit e lëndës, të përkrahur nga fasilitatorët dhe udhëheqja e shkollës. Programi do të sigurojë materialet e duhura dhe teknologjinë arsimore për implementimin e kurseve me bazë në shkollë. Gradualisht, shkollat, komuniteti dhe komunat do të inkurajohen që të sigurojnë një pjesë, apo të gjitha materialet, për jetësimin e aktiviteteve të kursit në shkollë. Këto aktivitete nuk do të jenë përsëritje dhe implementim i thjeshtë i përmbajtjes së kursit në shkollë, por përdorim kreativ i shkathtësive të fituara gjatë kursit, për të zhvilluar shkathtësitë relevante të nxënësve. Për këtë qëllim, të përkrahur nga fasilitatorët shkollorë, ata do të zhvillojnë planet përkatëse mësimore, do të jetësojnë aktivitetet, do të reflektojnë për cilësinë e implementimit dhe do të punojnë në portfolion e vet.

Për këtë pjesë të aktiviteteve mësimmhënësit do të organizojnë së paku tetë orë mësimore (përfshirë planifikimin, organizimin, reflektimin dhe portfolion) dhe do të përfitojnë nga 12 orë për llogari të licencimit të tyre.

Mësimmhënësit do të inkurajohen të organizojnë ekspozita të punimeve të nxënësve nga implementimi i këtyre aktiviteteve në klasë. Një ekspozitë e tillë do të duhej të ishte në përputhje të plotë me konceptin dhe planin e programin e lëndës, me qëllimet e kurrikulës kombëtare, dhe me shkathtësitë relevante të PATH-it.

Vlera e aktiviteteve të kursit e shprehur në orë për licensim

Kurs treditur në Qendrën për Ngritje Profesionale: 20 orë të llogaritura për licensim

Aktivitetet me bazë në shkollë: numër i caktuar i orëve të licensimit për çdo aktivitet të mbajtura me sukses (gjithsej 14 orë të llogaritura për licensim – shih në vijim)

Për implementim me bazë në shkollë të kursit “Sfida e dizajnit në të nxënit e teknologjisë“ janë caktuar aktivitetet në vijim (14 orë):

1. Sfida e dizajnit dhe të menduarit e dizajnit – prezantime
2. Njohja me pakon teknologjike dhe me përdorimin e veglave të punës
3. Një sfidë e vogël e dizajnit – me veglat e punës
4. Njohja me pajisjet teknologjike dhe me përdorimin e tyre
5. Një sfidë e dizajnit me pajisje teknologjike – semaforët
6. Përdorimi i krahut robotik – një sfidë e vogël
7. Përdorimi i lego-robotit – një sfidë e vogël
8. Punimi i kolovajzës – një ditë pune.

Programi ka gjithsej **34 orë**.

Vlerësimi/Certifikimi

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminareve mbi 90 %, vlerësimi pozitiv i orëve të përkrahura e të monitoruara mësimore, përgatitja e dosjes dhe pjesëmarrja në takimet e reflektimit